



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

VENDIM

Nr. 119, datë 09.09.2019

PËR NDALIMIN E KANDIDIMIT TË ZNJ. ZHAKLINA PETO NË VENDIN
VAKANT PËR GJYQTAR NË GJYKATËN KUSHTETUESE, VAKANCË E
PARAKOHSHME, SHPALLUR NGA PRESIDENTI I REPUBLIKËS NË DATËN
07.02.2018

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, i përbërë nga :

Ardian Dvorani	- Kryetar
Vitore Tusha	- Zëvendëskryetare
Arta Marku	- Anëtar
Margarita Buhali	- Anëtare
Fatjona Memçaj	- Anëtare
Fatri Islamaj	- Anëtar
Eriol Roshi	- Anëtar/Relator

Asistuar nga sekretare **Dorina Dulaj**.

Me praninë e përfaqësuesit të Avokatit të Popullit, **Z. Enio Haxhimihali**, në cilësinë vëzhguesit të përhershëm të mbledhjeve dhe veprimtarisë së Këshillit të Emërimeve në Drejtësi,

Me praninë e përfaqësuesve të autorizuar të subjekteve të ftuara sipas ligjit për pjesëmarrje, në cilësinë e vëzhguesve, në mbledhjen e Këshillit:

- **z. Bledar Dervishaj**, përfaqësuesi i autorizuar i Presidentit të Republikës,

në mbledhjen e datës 09.09.2019, mori në shqyrtim çështjen që i përket:

**KANDIDATE PËR GJYQTARE
NË GJYKATËN KUSHTETUESE:**

Znj. Zhaklina Peto

OBJEKTI:

Urdhërimi i ndalimit të kandidimit të znj. Zhaklina Peto, në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e parakohshme, të shpallur nga Presidenti i Republikës, në datën 07.02.2018.

KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

Pasi dëgjoi relatimin e anëtarit të Këshillit, **z. Eriol Roshi**, mendimin e paraqitur nga përfaqësuesi i Avokatit të Popullit, Z. Enio Haxhimihali, në cilësinë e vëzhgueses së përhershme në mbledhjen dhe veprimtarinë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, lidhur me mënyrën e procedimit të ndjekur për verifikimin e kandidates dhe si bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Në zbatim të nenit 125 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 7/b të Ligjit nr. 8577/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese në Republikën e Shqipërisë”, Presidenti i Republikës, në datën 07.02.2018, ka shpallur hapjen e procedurës së aplikimeve për plotësimin e vendit vakant/vakancë të parakohshme, të krijuar në Gjykatën Kushtetuese pas mbarimit përpara kohë të mandatit të ish-gjyqtarit Bësnik Imeraj.

2.2 Në përfundim të procedurës së aplikimeve për shprehjen e interesit për kandidim, Presidenti i Republikës si ka dërguar Këshillit të Emërimeve në Drejtësi aplikimet e kandidatëve të shfaqurara me dokumentet e paraqitura prej tyre për përmbushjen e kushteve dhe kriterëve ligjore të përcaktuara në nenin 7/a të Ligjit nr. 8577/2000.

3.3 Ndërmjet kandidatëve që kanë shprehur interesin për plotësimin e këtij vendi vakant të krijuar në Gjykatën Kushtetuese është edhe znj. Zhaklina Peto.

4.4 Në zbatim të nenit 125 dhe 149/d të Kushtetutës, të pikës 2 të nenit 7/b të Ligjit nr. 8577/2000, të neneve 229, pikë 1 e nenit 234, 235, 236, 237, 239 e 240 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si edhe të pikës 98 të aktit nënligjor normativ, Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, në mbledhjen e zhvilluar në datën 05.04.2019, vendosi fillimin e procedurave të verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes të kandidatëve që kanë shprehur interesin për vendet vakante të krijuara në Gjykatën Kushtetuese.

5.5 Në zbatim të nenit 228 të Ligjit nr. 115/2016 dhe të pikave 5, 27 deri 37 dhe 41 të aktit nënligjor normativ, Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 2 datë 15.02.2019 “Për procedurën e shortit të caktimit të relatorëve për pozicionet vakante në çdo institucion”, si edhe të pikës 4 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, në të njëjtën ditë të mbledhjes së zhvilluar në datën 05.04.2019, është realizuar edhe procedura për caktimin me short manual të relatorëve për secilin nga vendet vakante të krijuara në Gjykatën Kushtetuese dhe për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë.

6. Sipas rezultatit të shortit manual të realizuar nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, lidhur me vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e parakohshme, të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 07.02.2018, relator për ndjekjen e procedurave të verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidaturave, është caktuar anëtar i Këshillit, Z. Eriol Roshi.

7. Znj.Zhaklina Peto, si njëra nga kandidatët që kanë shprehur interesin për vendin vakant të sipërcituar në Gjykatën Kushtetuese, në zbatim të pikës 22 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi me nr. 4 datë 11.03.2019 “*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, është njoftuar me shkrim për t’u paraqitur pranë Këshillit për të vijuar me përmbushjen e procedurave të verifikimit të kandidaturës. Njoftimi me shkrim, i kryer në rrugë elektronike në adresën e deklaruar nga vetë kandidatja Zhaklina Peto, gjendet i administruar në dosjen e kandidatës.

8. Në datën 15.04.2019, kandidatja Zhaklina Peto është paraqitur pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi dhe është pajisur me formularët e deklaramit dhe autorizimet që duhet të plotësohen për qëllimet e vijimit të procedurës së verifikimit të kandidaturës së saj. Kryerja e kësaj procedure vërtetohet nga nënshkrimi prej vetë kandidatës së Deklaratës përkatëse, e cila gjendet e administruar në dosjen e kandidatës.

9. Në datën 16.04.2019, kandidatja Zhaklina Peto ka depozituar në sekretarinë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi formularë të deklaramit dhe autorizimet përkatëse për qëllimet e vijimit të procedurës së verifikimit të kandidaturës së saj, të cilat gjenden të administruara në dosjen e kandidatës.

10. Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, lidhur me verifikimin dhe kontrollin e pasurisë, në zbatim të shkronjës “dh” të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, të nenit 235 të Ligjit nr. 115/2016, si edhe në zbatim të pikës 60 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, me shkresën nr. 265 prot., datë 19.04.2019, Këshilli i ka dërguar ILDKPKI-së listën e kandidatëve dhe personave të lidhur me ta që i nënshtrohen procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve të tjera ligjore të kandidimit sipas Ligjit nr. 8577/2000 dhe Ligjit nr. 115/2016.

11. Bashkëlidhur kësaj shkrese drejtuar ILDKPKI-së, ndërmjet të tjerave, është vendosur edhe Deklarata e nënshkruar nga kandidatja Zhaklina Peto, ku tregohet se është pajisur me formularët e deklaramit dhe autorizimet që duhet të plotësohen për qëllimet e procedurës së verifikimit të kandidaturës së saj, si edhe data e nënshkrimit, nga e cila fillojnë të llogariten afatet e përcaktuara nga ligji për përmbushjen e detyrimeve ligjore të kandidatës për procedurën e verifikimit të kandidaturës.

12. Me shkresën nr. 2854/4 prot., datë 03.05.2019, ILDKPKI ka informuar Këshillin e Emërimeve në Drejtësi se kandidatja Zhaklina Peto e ka përmbushur detyrimin e përcaktuar nga pika 2 e nenit 235 të Ligjit nr. 115/2016 për të dorëzuar të plotësuar pranë atij institucioni Deklaratën e Pasurisë dhe Interesave Privatë të Kandidatit për Pozicione të Ndryshme në Institucionet e Sistemit të Drejtësisë.

13. ILDKPKI, në zbatim të nenit 235 të Ligjit nr. 115.2015, të Ligjit nr. 9049/2003 dhe Ligjit nr. 9367/2005, me shkresën nr. 17/28 prot., datë 30.05.2019, ka dërguar pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi rezultatet e kontrollit të ushtruar për kandidaten Zhaklina Peto dhe personat e lidhur me të.

14. Gjithashtu, në funksion të ushtrimit të kompetencave të tij për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, për sa i përket kontrollit të pasurisë, në zbatim të pikës 4 të nenit 229 dhe 235 të ligjit nr. 115/2016, të shkronjës “e” të pikës 20, 24, shkronjës “b” të pikës 60 e vijues të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, edhe ky Këshill ka kryer veprimet verifikuese të kërkimit nga subjekte publike dhe private, brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, të të dhënave mbi pasuritë, interesat private dhe detyrimet financiare që ekzistojnë në emër dhe për llogari të kandidates Zhaklina Peto dhe personave të lidhur me të.

15. Për realizimin e veprimeve verifikuese të lidhura me kontrollin e pasurisë së kandidates Zhaklina Peto, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, në datën 17.04.2019, i është drejtuar me kërkesa për informacion institucioneve publike dhe subjekteve private (të cilat janë administruar në dosjen e kandidimit), si vijon:

- a) Institucioneve bankare: (1) Banka AlphaAlbania, (2) Banka Amerikane e Investimeve, (3) Banka Credins, (4) Banka e Bashkuar e Shqipërisë, (5) Banka e Kreditit e Shqipërisë, (6) Banka e Parë e Investimeve, (7) Banka IntesaSanpaolo, (8) Banka Kombëtare Tregtare, (9) Banka Ndërkombëtare Tregtare, (10) Banka Procredit, (11) Banka Raiffeisen, (12) Banka SocieteGenerale, (13) Banka Tirana dhe (14) Banka Union.
- b) Institucione financiare të licencuara nga Banka e Shqipërisë : (1) Ak-Invest, (2) AlbaniaLeasing, (3) CapitalInvest, (4) Easypaysh.p.k, (5) Final sha, (6) Fondi Besa, (7) IutecreditAlbania, (8) Landeslease, (9) M – Paysh.p.k. (10) NOA sha, (11) PorscheLeasing, (12) Posta Shqiptare, (13) RaiffeisenLeasing, (14) Shoqëria e Parë Financiare e Zhvillimit – FAF, (15) Tirana Factoring&Lease, (16) Tranzit sha, (17) Union Financiar Tiranë.
- c) Subjekte financiare të licencuar nga AMF : (1) Fondi i Pensionit Vullnetar Credins Pension, (2) Fondi i Investimit Credins Premium, (3) Fondi i Investimit RaiffeisenInvest Euro, (4) Fondi i Investimit Raiffeisen Prestigj, (5) Fondi i Investimit RaiffeisenVision, (6) Fondi i Investimit ËVP Top Invest, (7) Fondi i Pensionit Vullnetar Raiffeisen, (8) Fondi i Pensionit Vullnetar Sigal.
- ç) Institucione të tjera publike si : (1) Agjencia Shtetërore e Kadastrës, (2) DPSHTRR, (3) D.P.Tatimeve, (4) M.Drejtësisë, (5) OSHEE, (6) QKB, (7) UKT.

16. Në përgjigje të kërkesave për informacion të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, të gjitha institucionet publike dhe subjektet private të treguara në pikën 15 më sipër, kanë dërguar pranë Këshillit përgjigjet përkatëse ku përmbahen të gjitha të dhënat e kërkuara mbi pasuritë e kandidatëve, nëse kanë pasur të tilla për secilin prej tyre, përfshirë edhe kandidaten Zhaklina Peto.

17. Në lidhje me rezultatet e kontrollit të ushtruar dhe përfundimet e raportit të ILDKPKI, Këshilli ka njoftuar kandidaten Zhaklina Peto, për të dhënë shpjegimet përkatëse mbi këto gjetje, si dhe të depozitojë çdo dokument justifikues që ai disponon.

18. Kandidatja Zhaklina Peto, me shkresën e datës 06.06.2019, nr. 380 prot. të Këshillit, ka dhënë shpjegimet përkatëse dhe ka bashkëlidhur dokumentacion justifikues.

19. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, mbi kërkesën e relatorëve për vendet vakante ku ka aplikuar kandidatja Zhaklina Peto, në mbledhjen e datës 24.07.2019 ka vendosur të caktojë ekspertin kontabël të autorizuar dhe auditues ligjor, zotin Arqile Mishtaku për të marrë nga ai mendimin e specializuar lidhur me disa të dhëna dhe çështje që rezultuan nga kontrolli pasuror dhe përfundimet e arritura nga ILDKPKI në kontrollin e pasurisë së kandidatës Zhaklina Peto, si edhe nga shpjegimet dhe dokumentacioni shtesë i paraqitur përpara Këshillit nga kjo candidate.

20. Për caktimin e ekspertit Arqile Mishtaku, në datën 25.07.2019, është njoftuar në rrugë elektronike kandidatja Zhaklina Peto për të bërë me dije nëse gjendet në konflikt interesi apo papajtueshmërie me këtë ekspert.

21. Kandidatja Zhaklina Peto, në rrugë elektronike, ka njoftuar në datën 25.07.2019 se nuk ka as konflikt interesi dhe asnjë shkak papajtueshmërie me ekspertin e caktuar.

22. Gjithashtu, po në datën 25.07.2019, ekspertit Arqile Mishtaku i është kërkuar të verifikojë dhe deklarojë nëse gjendet në konflikt interesi apo papajtueshmëri me kandidaten Zhaklina Peto, i cili deklaroi se nuk ka as konflikt interesi dhe asnjë shkak papajtueshmërie me të.

23. Eksperti Arqile Mishtaku, përpara fillimit të kryerjes së detyrës dhe marrjes në dorëzim të dokumentacionit objekt ekspertimi, nënshkroi rregullisht deklaratën e betimit.

24. Në datën 29.07.2019, eksperti Arqile Mishtaku depozitoi në zyrën e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi materialin që përmban mendimin me shkrim lidhur me çështjet për të cilat nga ky Këshill ishin caktuar detyrat e ekspertimit.

25. Po, në datën 01.08.2019, kandidatja Zhaklina Peto, nëpërmjet rrugës elektronike është njohur me mendimin me shkrim të ekspertit dhe, në përgjigje, nuk ka shprehur kundërshti për gjetjet dhe përfundimet përkatëse.

26. Gjithashtu për këtë rast kandidimi, me shkresën nr. 268 prot., datë 19.04.2019, Këshilli vlerësoi t'i drejtohet me kërkesa për informacion Fakultetit të Drejtësisë të Universitetit të Tiranës, pranë të cilit kandidatja Zhaklina Peto ka ushtruar funksione publike ose veprimtari private profesionale apo ku gjenden të dhëna lidhur me ushtrimin e detyrave dhe veprimtarinë profesionale të saj.

27. Lidhur me të dhënat e kërkuara, Këshilli ka marrë përgjigje me shkrim nga Fakulteti i Drejtësisë të Universitetit të Tiranës, me shkresën nr. 144/1 prot., datë 23.04.2019.

28. Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, lidhur me verifikimin dhe kontrollin e integritetit, në zbatim të shkronjës “ç” të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, të nenit 236 të Ligjit nr. 115/2016, si edhe në zbatim të pikës 82 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, me shkresën nr. 110 prot., datë 17.04.2019, Këshilli ka dërguar në Prokurorinë e Përgjithshme për kompetencë formularin e vetëdeklarimit të plotësuar sipas Ligjit nr. 138/2015 nga kandidatja Zhaklina Peto.

29. Prokuroria e Përgjithshme, me shkresën nr. 1134/169 prot., datë 28.05.2019, ka dërguar pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi rezultatet e kontrollit të ushtruar për kandidaten Zhaklina Peto.

30. Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, lidhur me verifikimin dhe kontrollin e integritetit të kandidates Zhaklina Peto, në zbatim të shkronjës “ç” të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, të nenit 236 të Ligjit nr. 115/2016, si edhe në zbatim të pikës 84 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, Këshilli i është drejtuar me kërkesë për informacion Drejtorisë së Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar (*shkresa nr. 120 prot., datë 17.04.2019*), Shërbimit Informativ të Shtetit (*shkresa nr. 114 prot., datë 17.04.2019*), Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes (*shkresa nr. 118 prot., datë 17.04.2019*) dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat pranë Ministrisë së Brendshme (*shkresa nr. 117 prot., datë 17.04.2019*).

31. Gjithashtu, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, në vijim të procedurës së sipërcituar për verifikimin e integritetit, me shkresën nr.352 prot., datë 20.05.2019, i është drejtuar Drejtorisë së Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar me kërkesë për ndihmë administrative për përpunimin e informacionit të klasifikuar të kërkuar pranë institucioneve përkatëse ligjzbatuese për qëllimet e verifikimit të integritetit të kandidatëve.

32. Drejtoria e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar dhe Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat pranë Ministrisë së Brendshme kanë dërguar përgjigjet e tyre, përkatësisht me shkresat nr. 1545 prot., datë 10.06.2019 dhe nr. 680/1 prot., datë 15.05.2019, mbi të dhënat e kërkuara për të gjithë kandidatët, përfshirë edhe kandidaten Zhaklina Peto.

33. Në vijim të procedurave të verifikimit dhe kontrollit të integritetit, në zbatim të nenit 229 dhe 236 të Ligjit nr. 115/2016, të dispozitave të ligjit nr. 45/2015, si edhe në zbatim të pikës 85 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, me shkresën nr. 112 prot., datë 17.04.2019, Këshilli ka dërguar formularin e aplikimit përkatës të plotësuar sipas ligjit nga kandidatja Zhaklina Peto për kompetencë dhe shqyrtim Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit.

34. Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit, me shkresën nr. 551/1 prot., datë 03.05.2019 ka dërguar Vendimin nr. 271 datë 02.05.2019 pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi me rezultatet e kontrollit të ushtruar për kandidaten Zhaklina Peto.

35. Lidhur me kushtin e kandidimit të parashikuar nga pika 5 e nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronja “c” e pikës 1 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, pra që kandidati të mos ketë mbajtur pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit, Këshilli në datën 02.05.2019 i është drejtuar me kërkesë për informacion partive politike, si dhe Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (*shkresa nr. 270 prot., datë 19.04.2019*), duke i bashkëlidhur listat e të gjithë kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese dhe për Inspektor i Lartë të Drejtësisë. Në përgjigje të këtyre kërkesave, KQZ dhe parti politike kanë dërguar informacione lidhur me ekzistencën ose jo të të dhënave që do të vërtetonin

angazhimin në ndonjë pozicion drejtues në parti politike të secilit prej kandidatëve, përfshirë edhe kandidaten Zhaklina Peto.

36. Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, në zbatim të shkronjave “b”, “c” dhe “d” të pikës 1, pikës 2 dhe 3 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, të nenit 237 dhe 240 të Ligjit nr. 115/2016, si edhe në zbatim të pikave 91 - 93 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, Këshilli ka marrë në shqyrtim dokumentacionin përkatës të depozituar nga vetë kandidatja Zhaklina Peto në momentin e kandidimit pranë organit të emërtesës që ka shpallur vendin vakant.

37. Në përfundim të veprimeve dhe procedurave të kontrollit dhe verifikimit, në zbatim të neneve 235, 236 dhe 237 të ligjit nr. 115/2016, si edhe të pikave 29, 75, 87 dhe 94 të Vendimit nr. 4 datë 11.03.2019 “*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, është proceduar me përgatitjen e relacionit përkatës mbi gjendjen e faktit dhe të ligjit të zbatueshëm duke e dërguar çështjen për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit.

38. Në zbatim të pikës 33 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, Kryetari ka thirrur mbledhjen e Këshillit duke njoftuar anëtarët për zhvillimin e saj në datën 02.08.2019, rendin e ditës, si edhe duke i bashkëlidhur njoftimit materialet e çështjes. Në rendin e ditës është përfshirë edhe çështja me objekt shqyrtimin e gjetjeve në procedurën e verifikimit të kandidimit të znj. Zhaklina Peto, për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e përkohshme, të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 07.02.2018.

39. Relatori i ngarkuar sipas shortit, në përfundim të veprimeve të procedurës së verifikimit të kandidaturës, ka përgatitur relacionin përkatës dhe ky relacion është trajtuar në mbledhjen e KED-së datë 02.08.2019. Në përfundim të procedurës së verifikimit, me vendimin nr. 108, datë 02.08.2019 KED ka vendosur ndalimin e kandidimit të kandidates Zhaklina Peto, në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e parakohshme, të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 07.02.2018.

40. Duke qenë se lista e kandidatëve për këtë pozicion vakant ka mbetur me dy kandidatë si rezultat i vendimit të sipërcituar, KED në mbledhjen e datës me vendimin nr. 116, datë 09.08.2019 ka vendosur : “Pezullimin e procedurës së verifikimit të kandidatëve dhe njoftimin e subjektit që e ka vënë në lëvizje, Presidentin e Republikës për vlerësuar rishpalljen e thirrjes për paraqitjen e kandidatëve...”.

41. Kundër vendimit nr. 108, datë 02.08.2019 të KED, kandidatja Zhaklina Peto ka paraqitur ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, e cila, me vendimin nr. 201, datë 22.08.2019, ndër të tjera ka vendosur shfuqizimin e vendimit nr. 108, datë 02.08.2019 të KED-së .

42. Bazuar në vendimin nr. 201, datë 22.08.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit, pas shqyrtimit të gjendjes së procedimit në mbledhjen e datës 03.09.2019, me vendimin nr. 117 datë 03.09.2019, KED ka vendosur revokimin e vendimit të tij të cituar në pikën 40 më sipër. Po kështu, KED në të njëjtin vendim ka vendosur vijimin me përparësi të procedurës së verifikimit të kandidaturës së Znj. Zhaklina Peto për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese,

vakancë e parakohshme, e shpallur me Dekretin nr. 10723, datë 07.02.2018 të Presidentit të Republikës.

43. Po kështu, bazuar në vendimin nr. 201, datë 22.08.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit dhe në pikën 74 shkronja "a" të Kreut IV të Vendimit nr. 4, datë 11.03.2019 të KED-së " *Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë*", në mbledhjen e datës 03.09.2019, KED ka vendosur që të të thërrasë ekspertin kontabël Z. Arqile Mishtaku në mbledhjen e Këshillit për të dhënë shpjegime në mbledhjen e Këshillit, njëkohësisht duke e njoftuar edhe kandidaten Zhaklina Peto dhe orientuar për të sjellë pyetje të natyrës sqaruese sipas vlerësimit të saj.

44. Në datën 04.09.2019 është zhvilluar mbledhja e Këshillit, ku është paraqitur eksperti dhe është proceduar me dhënien e përgjigjeve në lidhje me pyetjet sqaruese të ngritura nga anëtarët e Këshillit, përfaqësuesi i Avokatit të Popullit dhe nga vetë kandidatja Zhaklina Peto, e cila i ka paraqitur ato paraprakisht me shkrim në rrugë elektronike. Të dhënat e përfituara nga kjo mbledhje trajtohen në vijim të relacionit.

45. Në këto kushte, në zbatim të pikës 22 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi me nr. 4 datë 11.03.2019 "*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*", relatori i këtij pozicioni vakant, edhe për arsyet e treguara më sipër, ka përgatitur relacionin për gjetjet në procedurën e verifikimit të kandidaturës së znj. Zhaklina Peto, si njëra nga kandidatet që ka shprehur interesin për vendin vakant të sipërcituar në Gjykatën Kushtetuese.

46. Në zbatim të pikës 33 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 "*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*", Kryetari ka thirrur mbledhjen e Këshillit duke njoftuar anëtarët për zhvillimin e saj në datën 09.09.2019, rendin e ditës, si edhe duke i bashkëlidhur njoftimit materialet e çështjes. Në rendin e ditës është përfshirë edhe çështja me objekt shqyrtimin e gjetjeve në procedurën e verifikimit të kandidimit të znj. Zhaklina Peto, për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e përkohshme, të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 07.02.2018.

47. Në zbatim të pikës 34 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 "*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*", dita dhe koha e zhvillimit të mbledhjes, së bashku me relacionin e përgatitur nga relatori, i është njoftuar kandidates Zhaklina Peto, duke ndrequr kështu edhe shkeljen procedurale të konstatuar nga Gjykata Administrative e Apelit me vendimin nr. 201, datë 22.08.2019.

48. I njëjti njoftim, së bashku me relacionin e përgatitur nga relatori mbi veprimet e kryera gjatë procedurës së verifikimit dhe kërkesën e paraqitur nga kandidatja, i janë dërguar edhe Avokatit të Popullit.

49. Për zhvillimin e mbledhjes së Këshillit në datën 09.09.2019, rendin e ditës, relacionin e përgatitur dhe kërkesën e paraqitur nga kandidatja janë njoftuar edhe subjektet që sipas ligjit ftohen të marrin pjesë në mbledhjet e Këshillit.

50. Dita dhe koha e zhvillimit të mbledhjes, si edhe rendi i ditës janë njoftuar publikisht edhe në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e caktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

51. Pak përpara fillimit të mbledhjes së KED të datës 09.09.2019, kandidatja Zhaklina Peto ka parashtruar në rrugë elektronike një kërkesë me shkrim ku i kërkon Këshillit dhe të gjithë anëtarëve të vlerësojnë rastin e konfliktit të interesit e të pengesës ligjore për shkak se ata kanë shprehur mendim për ndalimin e saj me vendimin nr. 108, datë 02.08.2019. Lidhur me këtë çështje, bazuar në nenin 225/2 i Ligjit 115/2016, Kryetari i KED-së është shprehur me vendime të së njëjtës datë për rrëzimin e kërkesës, ndërsa për kryetarin e Këshillit është shprehur me vendim të së njëjtës datë Zv. Kryetarja e Këshillit, sërish duke e rrëzuar kërkesën.

52. Po kështu, në kërkesën e sipërpërmendur, kandidatja Zhaklina Peto kërkon nga Këshilli edhe që: “Përpara se të shprehet me një vendim përfundimtar në lidhje me lejimin ose ndalimin e kandidaturës time për gjyqtare në Gjykatën Kushtetuese, me qëllim dhënien e një vendimi të paanshëm dhe të bazuar mbi prova dhe fakte, si dhe kryerjen e një hetimi të plotë dhe të thelluar në lidhje me kontrollin e pasurisë time, KED duhet të kërkojë edhe një herë një vlerësim të thelluar pranë ILDKPKI, e cila duhet të bëjë një hetim të plotë, të të gjithë provave që do të administrohen për pasuritë objekt kontrolli, burimet e krijimit të pasurive, subjektet që kanë kontribuar në krijimin e tyre, transaksionet e ligjshme financiare mbi këto pasuri”. Në lidhje me këtë kërkesë në arsyetimin e vendimit jepet edhe qëndrimi i Këshillit.

53. Në mbledhjen e Këshillit, pas relatimit të parashtruar nga anëtari relator dhe shpjegimeve mbi pyetjet sqaruese të drejtuara nga anëtarët e Këshillit, Këshilli dëgjoi mendimin e përfaqësuesit të Avokatit të Popullit lidhur me mënyrën e procedimit të ndjekur për verifikimin e kandidates Zhaklina Peto.

54. Në lidhje me argumentet dhe kërkesën e kandidates për gjendjen e konfliktit të interesit të anëtarëve të Këshillit, përfaqësuesi i Avokatit të Popullit parashtroi se nuk është e mbështetur në ligj. Sipas ligjit mundësinë e rishqyrtimit të çështjes nga KED e parashikon ligji, por nuk tregon se rishqyrtimin e bën ndonjë organ tjetër apo që ky rast përbën konflikt interesi. I njëjti KED e rishqyrton çështjen ndaj edhe anëtarët e Këshillit nuk gjendet në kushtet e konfliktit të interesit.

55. Më tej, përfaqësuesi i Avokatit të Popullit u shpreh se ky institucion mban të njëjtin qëndrim si edhe në rastin e relacionit për këtë kandidate të shqyrtuar nga Këshilli në datë 02.08.2019. Në thelb, qëndrimi i Avokatit të Popullit mbi rastet e procedurës së verifikimit të kandidatëve është që kur konstatohen me probleme nga ILDKPKI ligji nuk është i qartë si vepron KED. ILDKPKI, ndryshe nga subjektet e tjera të kontrollit, për kandidatët e organeve të drejtësisë dhe subjektet e rivlerësimit kalimtar nuk zhvillon procedurë verifikimi dhe dëgjimi për të qartësuar gjetjet e kontrollit. Po kështu edhe afati ligjor 15 ditor i paraqitjes së Deklaratës së Pasurisë është shumë i shkurtër. Për këto raste, sikurse është edhe ai i kandidates Zhaklina Peto, pas shpjegimeve dhe dokumenteve që ka dhënë në KED, ndonëse nuk është i detyruar me ligj, mund ti kërkohej përsëri mendimi ILDKPKI apo rishikimi i raportit të kontrollit. Po kështu, ndërkohë që Këshilli ka miratuar në datën 24.07.2019 ekspertin mbi propozimin e relatorëve, kompetenca për caktimin e ekspertit është e Këshillit në kuadër të një gjetjeje të specifikuar duke përcaktuar po ky Këshill edhe pyetjet për ekspertin. Ky veprim ekspertimi është kryer vetëm për këtë kandidate ndërsa janë 11 kandidatë që kanë pasur raport negativ nga ILDKPKI, tregon për standard të ndryshëm nga

KED. Pas pyetjeve qe iu bënë relatorëve, jemi te mendimit se për të sqaruar tërësisht problematikat që ka paraqitur ILDKPI në raportin e tij çështja ka nevojë për hetim të mëtejshëm, duke iu drejtuar përsëri ILDKPKI.

II. Vlerësimi i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi

56. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, duke u bazuar në dispozitat ligjore dhe ato nënligjore normative të zbatueshme për çështjen në shqyrtim, si edhe në rrethanat e faktit që rezultojnë në aktet që përmban dosja e kandidimit, vlerëson se duhet të procedojë me vendim për ndalimin e kandidimit të kandidatës Zhaklina Peto për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e parakohshme, të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 07.02.2018.

57. Në pikën 4 dhe 5 të nenit 125 të Kushtetutës, parashikohet se:

“4. Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese duhet të kenë arsim të lartë juridik, të paktën 15 vjet përvojë pune si gjyqtarë, prokurorë, avokatë, profesorë ose lektorë të së drejtës, nëpunës të nivelit të lartë në administratën publike, me një veprimtari të spikatur në fushën e së drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose në sfera të tjera të së drejtës.

5. Gjyqtari nuk duhet të ketë mbajtur funksione politike në administratën publike ose pozicione drejtuese në një parti politike gjatë 10 vjetëve të fundit përpara kandidimit. Kritere të tjera, si dhe procedura për emërimin dhe zgjedhjen e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese rregullohen me ligj.”

58. Në pikën 1 dhe 2 të nenit 7/a të Ligjit nr. 8577/2000 parashikohet se:

“1. Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese mund të zgjidhet shtetasi shqiptar që përmbush këto kushte:

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;*
- b) të ketë mbaruar arsimin e lartë juridik, Diplomë e Nivelit të Dytë;*
- c) të mos ketë ushtruar funksione politike në administratën publike dhe të mos ketë mbajtur pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit;*
- ç) të mos jetë në procedim penal dhe të mos jetë dënuar me burgim për kryerjen e një vepre penale;*
- d) të mos jetë larguar nga detyra për shkaqe disiplinore dhe të mos ketë masë disiplinore në fuqi;*
- dh) të ketë kaluar me sukses procesin e kontrollit dhe verifikimit të pasurisë së tij personale dhe të familjarëve të tij, sipas ligjit.*

2. Kandidati që përmbush kushtet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, duhet të plotësojë edhe këto kritere:

- a) të ketë përvojë pune jo më pak se 15 vjet si gjyqtar, prokuror, avokat, profesor ose lektor i së drejtës, jurist i nivelit të lartë në administratën publike;*
- b) të ketë një veprimtari të njohur në fushën e të drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose sfera të tjera të së drejtës;*
- c) të jetë vlerësuar për aftësitë profesionale dhe integritetin etik e moral.”.*

59. Kushtet e kandidimit për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të parashikuara nga Kushtetuta dhe ligjet e nxjerra në pajtim me të, sikurse janë edhe ato të përmendura në pikat 57 dhe 58 më sipër, duhet të plotësohen secila dhe të gjitha së bashku në mënyrë që kandidati të pranohet për t'u vlerësuar dhe renditur sipas meritave nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi dhe më tej për t'u përzgjedhur gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese nga organi i emërtesës.

60. Për rrjedhojë, nëse kandidati për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese nuk plotëson qoftë edhe njërin prej kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, kjo do të përbënte motiv ligjor të mjaftueshëm për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi për të vënë në bisedim dhe për të disponuar ndalimin e kandidimit, **pa qenë më e nevojshme të arsyetojë për plotësimin ose jo të kushteve të tjera ligjore.**

61. Nisur nga të dhënat dhe gjetjet që rezultojnë nga procedura e verifikimit për kandidaten Zhaklina Peto, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi vlerësoi të bisedojë dhe të konkludojë pikësëpari në lidhje me plotësimin ose jo të kushtit ligjor të parashikuar nga shkronja "dh" e pikës 1 të nenit 7/a të Ligjit nr. 8577/2000,, pra që kandidati për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese të ketë kaluar me sukses procesin e kontrollit dhe verifikimit të pasurisë së tij personale dhe të familjarëve të tij, sipas ligjit.

62. Për sa i përket procedurës së verifikimit të pasurisë, në përfundim të veprimeve të kontrollit të ushtruar në zbatim të nenit 235 të Ligjit nr. 115.2015, të Ligjit nr. 9049/2003 dhe Ligjit nr. 9367/2005, ILDKPKI, me shkresën nr. 17/28 prot., datë 30.05.2019, ka dërguar pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi rezultatet e kontrollit të ushtruar për kandidates Zhaklina Peto dhe personat e lidhur me të.

63. Në përfundim të analizës së hollësishme financiare të kryer mbi bazën e gjetjeve të siguruar nga informacionet e dërguara nga institucione publike dhe subjekte private, lidhur me deklarin e pasurisë dhe interesave private të kandidates Zhaklina Peto, ILDKPKI në raportin e paraqitur ka ardhur në përfundimet se:

- a) Deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;
- b) Ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar burimin e pasurive;
- c) Ka mosdeklarime të pasurive dhe vlerave të tyre;
- ç) Nuk ka kryer deklarim të rremë;
- d) Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.

64. Përfundimet e sipërcituara të ILDKPKI, bazohen në gjetjet vijuese të raportit të kontrollit:

Pasaktësi në plotësimin e deklaratës së pasurisë, pasi kandidati nuk ka deklaruar sipërfaqen e shtesës në apartamentit prej 130 m2 në Rrugën "Ismail Qemali" Tiranë;

- **Mosdeklarim i vlerës** dhe burimit financiar të shpenzuar për shtesën me sipërfaqe 53.6 m2 dhe verandën me sipërfaqe 64 m2, në apartamentin në Rrugën "Ismail Qemali", Tiranë;
- Mungesë dokumentacioni justifikues lidhur me shumën e shpenzimeve dhe burimin financiar për shtesën, ndërtimin me sipërfaqe 53.6 m2 dhe verandën me sipërfaqe 64 m2 në Rrugën "Ismail Qemali" Tiranë, sipas lejes së legalizimit nr. 118163, datë 2.11.2016;
- Mungesë dokumentacioni justifikues ligjor për burimin e shumës prej 80.000 \$, deklaruar si dhuratë nga prindrit Vladimir dhe Shefikat Peto në Tetor 1999, pasi

referuar përgjigjes së ardhur nga ASHK rezulton se prindrit kanë shitur pasuri të paluajtshme në Janar 2000;

- Vlera prej 3.900.000 Lekë për blerjen e apartamentit të banimit me sipërfaqe 130 m² + 130 m² tarracë, në rrugën “IsmailQemali” Tiranë, në vitin 2000, gjykohet të jetë e ulët;

Kontrata të dyshimta lidhur me transaksionet e pasurive të paluajtshme:

- o Shkëmbimin e apartamenteve tek Kodra e Diellit, pasi jep apartamentet me sipërfaqe 110 m² dhe përfiton apartament me sipërfaqe 156 m²;
- o Shitjen e apartamentit në vitin 2018 në vlerën 170.000 Euro për përfituar nga shkëmbimi (i cili sipas kontratës në vitin 2017 është blerë për 117.150 Euro);
- Është e paqartë pagesa dhe burimi financiar i shumës 28.000 Euro në vitin 2016, konfirmuar nga DPPPP, kryer nga Zhaklina Peto në favor të “Agi Kons” sh.p.k., për kontratën me nr. 5870/2171, që përkon me apartamentin me sipërfaqe 110 m², me vlerë të deklaruar 96.950 Euro tek Kodra e Diellit;
- Mungesë dokumentacioni justifikues për kursimet familjare të deklaruara si burim financiar i apartamentit me sipërfaqe 110 m² me vlerë 96.950 Euro në rrugën “Kodra e Diellit” Tiranë, në periudhën 2009 – 2010 (pjesa tjetër kredi dhe të ardhura nga kontrata e qerasë 2009, 2010);
- Është e paqartë vlera e deklaruar 60.000 Euro për apartamentin 110 m² që shkëmbehet me apartamentin me sipërfaqe 151 m² tek Rezidenca Kodra e Diellit, Rruga e Ullinjve, me burim deklaratën noteriale nr. 1624/440, datë 20.04.2019. Burimi është kontrata e shitjes së pasurisë së paluajtshme me nr. 812 rep., datë 272 kol., datë 25.07.2014;

Nuk është specifikuar qartë burimi financiar i shumës 79.850 Euro, për blerjen e apartamentit me sipërfaqe 172.3 m² në adresën “Kodra e Diellit” Tiranë, në vitin 2017. Rezulton se pagesat në shumën 24.000 Euro në datën 3.5.2017 dhe 7.057.650 Lekë në datë 1.6.2018 të jenë kryer para përfitimit të shumës 155.000 Euro datë 20.06.2018, deklaruar si burim nga shitja e apartamentit me sipërfaqe 131 m² në vlerën 170.000 Euro, sipas kontratës së datës 06.06.2018;

Dokumentacioni jo i plotë ligjor lidhur me shumën e deklaruar të të ardhurave nga Fakulteti i Drejtësisë;

Rezulton se kandidati ka deklaruar kontratë qiraje datë 2.12.2009, me palë qiradhënëse Zhaklina Peto dhe qiramarrës CaboDrilling CORP të apartamentit nr. 5, pallati 11, rruga “Sami Frashëri” me sipërfaqe 35.5 m², pasuri për të cilën nuk ka deklaruar të dhëna lidhur me pronësinë, vlerën, kohën e përfitimit. Nuk është e qartë marrëdhënia juridike e kandidatit me këtë adresë;

- Rezulton se kandidati automjetin tip Passat e ka blerë 500.000 Lekë në vitin 2013 dhe e ka shitur 13.000 Euro në vitin 2017. Dyshime lidhur me diferencën e konstatuar të çmimit blerje/shitje.

65. Në lidhje me rezultatet e kontrollit të ushtruar dhe përfundimet e raportit të ILDKPKI, Këshilli ka njoftuar kandidaten Zhaklina Petonë datë 28.05.2019, në rrugë elektronike, për të dhënë shpjegimet përkatëse mbi këto gjetje, si dhe të depozitojë çdo dokument justifikues që ai disponon.

66. Kandidatja Zhaklina Peto, me shkresën e datës 06.06.2019, nr. 380 prot. të Këshillit, ka dhënë shpjegimet përkatëse dhe ka bashkëlidhur dokumentacion justifikues për konstatimet e ILDKPKI, duke parashtruar se :

a) Sa i takon konstatimit mbi apartamentin e ndodhur në Rrugën “Ismail Qemali” Tiranë, kandidatja shpjegon se :

- *Konkluzionet e ILDKPKI janë nxjerrë në mungesë të plotë të vëmendjes dhe të profesionalizmit;*
- *Lidhur me blerjen e apartamentit me sipërfaqe 130.3 m2 burimi i të ardhurave është kontrata e dhurimit të monedhës, datë 10.10.1999 nga prindrit e saj ;*
- *Lidhur me këtë apartament është dorëzuar edhe leja e legalizimit për sipërfaqen e ndërtimit 64.9 m2 verandë dhe ndërtim 53.6 m2 me datë 02.11.2016 dhe se megjithëse në deklaratë nuk është specifikuar konkretisht rezulton të jetë dorëzuar dokumentacioni ligjor që vërteton ekzistencën e saj. Ndërtimi pa leje është bërë nga shitësi dhe për rrjedhojë ka qenë i paregjistruar;*
- *Lidhur me burimin financiar të prindërve për shumën 80.000 USD shuma është dhuruar me Kontratën nr. 3840 Rep., nr. 445 Kol., datë 10.10.1999 dhe se burimi i krijimit të kësaj të ardhure nga prindrit ka qenë Kontrata e Shitjes me Rezervë nr. 2957 Rep., nr. 299 Kol., datë 15.06.1999, ku çmimi i përfituar nga shitja ka qenë 50.000 USD. Gjithashtu rezulton se nga Deklarata datë 20.06.1999 znj. S. R. i ka dhënë znj. Sh. P. shumën prej 30.000 USD me qëllim dhurimit të shumës vajzës për ta përdorur për blerjen e apartamentit. Për rrjedhojë provohet plotësisht me dokumentacion ligjor mundësia e prindërve për të dhuruar shumën 80.000 USD;*
- *Lidhur me vlerën 3.900.000 Lekë të përdorur për blerjen e apartamentit me 130.3 m2 sipërfaqe, ky apartament është blerë në vitin 2000 dhe shuma është paguar;*

b) Në lidhje me gjetjen e ILDKPKI se ka kontrata të dyshimta në lidhje me shkëmbimin e pasurive, kandidatja shpjegon se :

- *Kontrata e datës 23.04.2015 është kontratë e realizuar në formën e kërkuar nga ligji dhe se kandidati ka deklaruar se ka pasur të ardhura financiare në shumën 60.000 Euro të depozituara në Bankën Kombëtare Tregtare sh.a., me qëllim rregullimin e apartamentit dhe bërjen e tij të përshtatshëm për banim. Pas rivlerësimit të apartamentit ka dalë se vlera e tij është 170.000 Euro;*
- *Lidhur me pagesën 28.000 Euro në vitin 2016, shumë e cila përkon me apartamentin me sipërfaqe 110 m2, kandidatja sqaroi se kjo pagesë ka pasur për qëllim sistemimin e pagesës nëpërmjet bankës. sistemi i auditit e ka quajtur shkëlqje derdhjen Cash të kësaj shume dhe për rrjedhojë me datë 19.11.2016, me mandatin e pagesës 501, është kthyer shuma prej 28.000 Euro, pjesë e çmimit të porosisë, dhe pagesën e po kësaj shume me anë të bankës;*
- *Në lidhje me mungesën e dokumentit justifikues për të ardhurat e blerjes së apartamentit 110 m2 me shumën 96.950 Euro, në dokumentet e paraqitura është edhe një vërtetim i bankës mbi gjendjen e llogarisë, në të cilën pasqyrohen të gjitha të ardhurat nga puna e saj dhe e bashkëshortit. Nga shumatorja e të gjithë këtyre të ardhurave vërtetohet se bashkëshortët kanë pasur të ardhura të mjaftueshme për të përballuar shpenzimet e apartamentit;*

c) Në lidhje me gjetjen se nuk specifikohet burimi financiar i shumës 79.850 Euro, e përdorur për blerjen e apartamentit me sipërfaqe 172.3 m2 në vitin 2017, kandidatja sqaron se është marrë kredi në Tirana Bank SHA me datë 14.06.2017 dhe me këtë kredi është shlyer shuma 7.359.000 Lekë, ku si hipotekë ishte vënë apartamenti me sipërfaqe 131 m2 dhe 20 m2 verandë. Për të liruar apartamentin nga hipoteka, me qëllim për ta shitur pronën, është

realizuar deklarata noteriale datë 31.05.2018, me anën e së cilës është mbyllur kontrata e kredisë dhe është hequr hipoteka. Çmimi i blerjes së apartamentit është shlyer nga kontrata e shitblerjes me kusht kreditimi e datës 06.06.2018; 24.000 Euro, kandidatja shpjegon se shuma 24.000 euro përbën kursimet familjare nga paga e saj dhe fitimet e biznesit të bashkëshortit për periudhën 01.01.2016 deri në 01.06.2017;

ç) Në lidhje me të ardhurat nga pagat nga puna në Fakultetin e Drejtësisë, deri në vitin 2004 , kandidatja shpjegon se pagat merreshin me bordero dhe se për to ka vërtetime të paraqitura dhe se nga 2004 e deri në 2019 janë të paraqitura gjendjet e llogarive bankare;

d) Në lidhje me konstatimin e ILDPKI-së se kandidatja ka deklaruar kontratë qiraje datë 2.12.2009, me palë qiradhënëse Zhaklina Peto dhe qiramarrës Cabo Drilling CORP të apartamentit nr. 5, pallati 11, rruga “Sami Frashëri” me sipërfaqe 35.5 m2, pasuri për të cilën nuk ka deklaruar të dhëna lidhur me pronësinë, vlerën, kohën e përfitimit. Nuk është e qartë marrëdhënia juridike e kandidatit me këtë adresë, kandidatja ka shpjeguar se :

- Lidhur me pasurinë e paluajtshme të lëshuar me qera datë 02.12.2009 me palë qiramarrëse CaboDrilling CORP, pasuria është fituar me Kontratën e Shitjes nr. 468/372, datë 17.03.2000 dhe shumat e gjeneruara janë administruar nëpërmjet bankës dhe se të ardhurat e bashkëshortit, A. V., janë 15.740.597 Lekë;

67. Po kështu, në komunikimin elektronik të datës 03.09.2019 me Këshillin, kandidatja në lidhje me këtë çështje parashtron se, citoj : *“Gjithashtu, me qellim për të patur një tablo sa me të qarte në lidhje me gjetjet e ILDPKI dhe provave që une kam paraqitur, si dhe për të sqaruar çdo keq interpretim me dashje ose nga pakujdesia për pasuritë që une disponoj Kërkoj nga KED thirrjen e një eksperti topograf për të saktësuar vendodhjen hartografike të pasurisë objekt i kontratës së qirase, ndërmjet meje dhe subjektit Cabo Drilling kompani. Gjithashtu, në lidhje me këtë pasuri kërkoj që nga ana e KED të kërkohet sqarim shterues nga ekspertet e ILDPKI dhe të konstatohet nëse kjo pasuri është një pasuri e imja ekzistuese apo një gjetje e re e pa deklaruar prej meje”.*

68. Në lidhje me këtë kërkesë. Këshilli në mbledhjen e datës 04.09.2019 ka vendosur të mos e pranojë atë, pasi del e panevojshme marrja e një prove të tillë. Edhe mendimi i relatorit të çështjes ka qenë i njëjtë , pasi rezulton qartësisht se gjetja e ILDPKI-së në këtë rast i referohet një pasurie të paluajtshme e cila në fakt e ka origjinën te kontrata e datës 17.03.2000, të trajtuar më sipër, dhe ngatërresa eventualisht ka ndodhur pasi kontrata merr për referencë rrugën “Ismail Qemali” Tiranë , ndërsa gjendja aktuale e sipërfaqes prej 35.5 m2 lidhet me rrugën “Sami Frashëri” Tiranë ndërkohë që edhe kjo sipërfaqe është pjesë e pronës së blerë me kontratën e datës 17.03.2000, pra efektivisht bëhet fjalë për të njëjtën pronë, dhe kandidatja e ka sqaruar raportin e saj juridik me të.

69. **Në lidhje me gjetjen mbi automjetin PASSAT** kandidatja shpjegon se automjeti Passat, është blerë në vitin 2013 në vlerën 500.000 Lekë si okazion, pasi pala blerëse kishte probleme të rënda financiare dhe se në vitin 2017 është shitur 13.000 Euro. Blerësi i automjetit rezultoi ta ketë shitur në vitin 2019 për shumën 12.000 Euro, çka tregon vlerën reale të automjetit dhe gjendjen teknike të mirë të tij.

70. Po kështu, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi verifikoi përputhshmërinë e të dhënave të deklaruar nga kandidatja Zhaklina Peto në *Deklaratën e Pasurisë dhe Interesave Privatë të Kandidatit për Pozicione të Ndryshme në Institucionet e Sistemit të Drejtësisë* që ka depozituar pranë ILDKPKI, mbi bazën e të cilave ky institucion ka realizuar analizën financiare dhe ka ardhur në përfundimet e tij, në raport me të dhënat që rezultojnë nga informacionet e dërguara pranë Këshillit nga institucionet publike dhe private të treguara më lart këtij Vendimi, si dhe shpjegimet dhe dokumentacionin shtesë të paraqitur nga kandidatja Zhaklina Peto.

71. Eksperti i caktuar nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, në mendimin me shkrim të depozituar në datën 29.07.2019, lidhur me çështjet dhe detyrat e ngarkuara të ekspertimit, në përfundim të analizës së hollësishme financiare të bazuar në të gjithë dokumentacionin e administruar, në përgjigje të detyrave dhe udhëzimeve të ekspertimit, ka ardhur në përfundimet si më poshtë:

a) *Në lidhje me apartamentin 130 m², në rrugën Ismail Qemali,*

Pasuria e krijuar deri në vitin 2000 është e justifikuar ligjërisht me të ardhura të ligjshme të familjes të znj. Zhaklina Peto dhe personave të lidhur , burimi i krijimit të tyre është i vërtetuar plotësisht me dokumentacion ligjor.

b) *Në lidhje me apartamentin me sipërfaqe 110 m², Kodra e Diellit, Tiranë dhe në lidhje me të ardhurat nga puna të kandidatës*

Pasuritë e krijuara në vitet 1996 -2019 janë plotësisht të justifikuar nga të ardhura të ligjshme të familjes të znj . Zhaklina Peto dhe personat e lidhur me të , vlera totale e tyre është 55.68 % e të ardhurave familjare të krijuar në këto vite.

Në Aktin e ekspertizës të ILDKPKI , të ardhurat që znj. Zhaklina Peto ka përfutuar nga mbi ngarkesa orare në vite dhe pagat e përfutuar nuk janë të llogaritur drejtë , ne kemi mbledhur të gjitha kreditimet në dokumentin "Statement of Account" të BKT, Reiffeisen Bank, Procredit Bank, Credins Bank dhe Bankës Popullore të cilat janë në raportin e ILDKPKI në faqen 96 deri në faqen 443 .

Të ardhurat nga z. A V në vite të cilat ne i kemi llogaritur nga lëvizjet në dokumentin "Statement of Account" Banka ProCredit Nr llog103590280001 në Shumën prej 4,420,253.00 leke .

Shuma e të ardhurave që janë llogaritur në Aktin e ekspertizës nga ana e ILDKPKI (faqe 39 e raportit , Faqe 1531 e dosjes) janë si mëposhtë :

- *Për znj. Zhaklina Peto shuma e vlerësuar nga ILDKPKI është 29.000.000 lekë , kurse ne i kemi llogaritur në vlerën prej 35,254,386 diferenca është + 6.25.386 lekë (fq 39 raportit të ILDKPKI)*
- *Për A V shuma e vlerësuar nga ILDKPKI është 15.000.000 lekë , kurse ne i kemi llogaritur në vlerën prej 20.148.900 diferenca është +5.148.900 leke (fq 39 raportit të ILDKPKI)*
- *Shpenzimet jetike të vlerësuar nga ana e ILDKPKI është 12.000.000 lekë , kurse ne bazuar normave të konsumit të INSTAT-it për vitet 1996 deri në 03/2019 i kemi*

llogaritur në vlerën prej 11.372.000 diferenca është 628.000 lekë (fq 40 raportit të ILDKPKI)

c) Në lidhje me apartament me sipërfaqe 172.3 m2 dubleks, Kodra e Diellit, Tiranë

Pasurite e krijuara ne vitet 1996 -2010 janë plotësisht të justifikuar nga te ardhura te ligjshme te familjes të znj. Zhaklina Peto dhe personat e lidhur me te , vlera totale e tyre është 63.52 % e të ardhurave familjare te krijuar në këto vite.

72. Në mbledhjen e datës 04.09.2019, sipas arsyeve që tregohen në këtë vendim dhe kryesisht mbi konstatimin e Gjykatës Administrative të Apelit e cila në faqen 25 të vendimit , paragrafi i dytë, ka konstatuar si shkelje mosthirrjen e ekspertit, në mbledhjen e Këshillit, është paraqitur për të dhënë shpjegime nëse i kërkohen nga Këshilli, eksperti kontabël Arqile Mishtaku.

73. Mbi njoftimin e KED nëse ka pyetje për ekspertin, kandidatja Zhaklina Peto, në komunikimin elektronik të datës 03.09.2019 ka parashtruar se :

"1-Ne pyetjen e pikes A, do doja te me saktësohet pyetja e 3-te e pikes A. Pyetja me duket e pa plote , ky fakt nuk qarteson qellimin e pyetjes!

2- Nga ecuria kronologjike e relacionit me rezulton se kalohet nga Pyetja A ne pyetjen C, A ka realisht nje pyetje B ? Nese po a mund te informohem ne lidhje me te".

74. Në lidhje me këto çështje eksperti sqaroi se, citohet procesverbali :

" Atëherë duke gene se është ezauruar pyetja " a". Është lënë të saktësohet pika 3 e pyetjes "a" për të saktësuar saktë lidhur me informacionin për sipërfaqen e objektit të prej 130 m2. Normalisht ne jemi bazuar tek dokumentacioni, bazuar në certifikatën pronës ku është shënuar 130.3 m2 por do doja të theksoja në fillim që në kontratën që është hartuar në vitin 2000, kontrata me nr. 1468 e datës 17 Mars është përcaktuar që blerja e apartamentit është 130 m2 plus tarracën, dhe mbi këtë bazë ne kemi vlerësuar pjesën e apartamentit dhe nuk mund të vlerësojmë tarracën për efekte të, pra në kontrata është shënuar vetëm apartamenti, në katin e 3 dhe nuk ka, dhe është shënuar aty në kontrate dhe tarracë, mbi këtë bazë mbi dokumentat që kemi gjetur në dosjen e ILDKP ekziston dhe deklarimi i pasurisë tek ALUIZMI, por aty nuk ka ndonjë preventiv apo situacion nga vet-deklaruesi apo nga vete institucioni lidhur me pjesën tjetër që është ngritur mbi tarrace. Duke qenë që nuk ka, ka krijuar nga ana e ILDKPKI janë krijuar dyshime lidhur me çmimin jemi referuar dy vendimeve që ndodhen aktualisht në sajtin zyrtarë të EKB dhe VKM të vitit 1999 dhe 2000. VKM i vitit 1999 në pikën 5 përcaktohet që në rrethin e Tiranës nuk ka informacion nga institucionet përkatëse në lidhur me çmimet e tregut dhe as për kostot e ndërtimit të apartamenteve në të gjithë Tiranën aq me tepër ne zonën nr. 5 që i ka qenë ky apartament dhe në vitin 2000 është përcaktuar saktë në kemi përcaktuar saktë që duke qenë që i jemi referuar këtij vendimi çmimi ose kosto ndërtimore sepse s'ka patur përsëri informacion mbi çmimet, rezulton nga 29 e 800 ne 33 e 950 dhe ne e kemi llogaritur mbi sip 130.3 m2 pra aq sa përmban dosja pra nuk kemi informacione të mëtejshme në dosje as nga ILDKPI-ja që ne të formojmë një opinion më të qartë dhe analizë më të thelluar mbi këtë, dhe çmimi dhe vlera e kësaj është qëndron mbi këto dokumente dhe në këtë vlerë.

Lidhur me pyetjen e 2-të është kaluar nga "a" të "c" dhe "b"-ja. faktikisht "b"- "d" e kemi bërë bashkë për shkak se ILDKPI-ja nuk ka bërë një analizë ekonomiko-financiare te dhënave por është bazuar mbi bazën e konfirmimeve zyrtare të institucioneve ligj-zbatuese.

Ne kemi marrë dhe të gjithë statement e bankave nga viti 20005-2019 pasi është i vetmi informacione që jep në mënyrë të detajuar të gjitha të ardhurat e krijuara nga subjekti nga kandidatja dhe nga personat e lidhur familjare me të dhe mbi këtë bazë kemi analizuar të gjithë informacionin e marrë nga banka nga vetë

Na është kërkuar të bëhen të veçanta por për shkak se për ndërtimin e një pasqyre financiare ndër vite për veç burimit të ardhurave që kërkon pasqyra transaksionet e pasurisë në zbritje apo në shtesë apo detyrime të tjera borxhe pozitive apo negative dhe shpenzimet jetike, ne na duhet dhe gjendja e KESH-it ose e mjeteve monetare në fund të vitit për të cilin subjekti nuk e ka patur detyrimin nga ligji sepse nuk ka deklaruar në ILDKP dhe s`mund ta marr këtë informacion. Në këto kushte ne kemi bërë pasqyrën ekonomiko- financiare pra buxheti familjarë të kandidatit nga viti 2005 deri në mars të 2018 në total dhe rezultatin e kemi paraqitur tek pjesa e raportit në mënyre të përmbledhur shpresoj kjo është gjithë mendimi që kemi dhënë bazuar në dokumente, nëse do këtë dokumente të tjera shtesë ne jemi te gatshëm që të operojmë por edhe të japim konkluzione te mëtejshme”.

75. Më tej, në lidhje me pyetjet e anëtarëve të Këshillit, eksperti ka sqaruar se licenca e tij është ajo e ekspertit kontabël dhe jo e vlerësuesit të pasurive të paluajtshme. Por eksperti sqaron se për qëllime fiskale sa i takon ALUIZN-it vlera minimale për qytetin e Tiranës është 30.000 lekë.

76. Po kështu, eksperti ka sqaruar se në VKM e referuara për efekt të kontratës së datës 17.03.2000 ka patur parasysh sipërfaqen e pasurisë së blerë dhe nëse do të llogariteshin me çmimin e këtyre VKM edhe sipërfaqja e shtesës , vlera e kontratës do të ndryshonte dhe do të shtohet .

77. Në vijim, eksperti sqaron se përse në tabelat financiare llogaritja është bërë e përmbledhur dhe jo vit pas viti. Sipas ekspertit :

“tek faqja 4, 5, 6, 7 dhe kemi dhënë analizën për vitet 1996-2010, pasi kemi patur një bazë e të të dhënave, dhe të ardhurave ose të Keshit në llogaritë bankare. Nuk kemi patur të keshit personal, apo të keshit familjar. Për shkak se ne nuk kemi keshin familjar dhe subjekti nuk e ka pasur detyrim të deklaronte, sepse nuk ka qenë subjekt i deklarimit në ILDKP, normalisht opinionin jonë do të ishte një opinion jo i saktë sepse nuk kemi Keshin. Nëse do të kishim keshin çdo vit ne do ta nxirrnim por ne kemi bërë për vitin 1996 – 2010 të ardhurat mbulojnë të gjitha, pasuria, transaksionet e pasurisë që ka fituar subjekti po dhe së bashku me personat e lidhur. Duke zbritur shpenzimet jetike ose çdo lloj detyrimi tjetër, dhe duke zbritur gjendjen në llogarinë bankare tek pasqyra tek pika 7, pra, një gjendje prej 150 mijë lekësh 585. Rezulton një gjendje pozitive e të ardhurave të saj prej 6 milion lekësh. Po përsëri po them, ne këtu nuk kemi keshin të deklaruar në vite. Nëse do të kishim dhe keshin, normalisht të ardhura do të kishim më shumë. Po nga ky vit deri në 2010, ne të gjitha transaksionet që janë kryer janë me burime të justifikuara nga të ardhurat. Unë theksoj këtu edhe diçka tjetër sepse prandaj i jemi futur pjesës së bankave për arsye sepse jo të gjitha institucionet e japin informacionin e duhur, në rastin kur një subjekt krijon të ardhura. Një fakt shumë të thjeshtë. Listë pagesat e punonjësve kanë afate mbahen % dhe çdo institucion e ka për detyrë të mbaj një listëpagesat dhe të ardhurat e secilit prej punonjësve kurse të ardhurat që përfitojnë punonjësit në rastin e honorarëve” ato nuk janë të kontabilizuara në mënyrë individuale për secilin që i merr por ata varen brenda “ opsionit” në llogaritë e secilit institucion, po nëse, kush është i interesuar le të vej të marr vërtetim nuk i del më si burim të të ardhurash. Prandaj, dhe unë i jam futur bankës sepse vetëm banka është ajo të cilat, edhe këtu është ajo

pjesa e institucioneve që kanë dhënë këtë honorar në bankë, nëse e kanë dhënë kesh, përsëri kjo nuk mund të gjendet. Dhe prandaj të ardhurat janë disi më të larta sa hera e kaluar nga ILDKP-ja. Dhe ne i jemi futur të gjithave të ardhurave e burimeve nga bankat dhe dalin të gjitha të ardhurat më lartë, por më kryesisht tek bashkëshorti 4.5 milion lekë më shumë sesa ka gjetur ILDKP-ja. Pra, ILDKP-ja është mbështetur vetëm tek pjesa e vërtetimeve konfirmuese dhe jo tek analiza e bankave. Që ne këtu i jemi futur dhe kemi gjetur këtë rezultat”.

78. Eksperti ka sqaruar gjithashtu se në vitin 2011 kandidatja ka patur të ardhura mbi 2 milion lekë dhe se i ka deklaruar në DIVA pranë organit tatimor dhe se prej tij nuk është kontrolluar nëse deklaratimet kanë qenë të rregullta apo jo por tatimi mbi të ardhurat konsiderohet si shpenzim dhe zbritet nga të ardhurat dhe diferenca në çdo rast shko n deri në 7%. Për të gjitha shpenzimet jetësore eksperti parashtron se i është referuar të dhënave të INSTAT.

79. Pyetjeve të përfaqësuesit të Avokatit të Popullit , eksperti iu përgjigj si më poshtë, citoj :

“Përfaqësuesi i Avokatit të Popullit : Ky dokumentacion iu është dhënë me procesverbal, sepse nuk e del qartë cilat dokumenta keni parë, si ju është vënë në dispozicion dokumentacioni??. Ka një procesverbal që ju dha 10 mijë faqe, 5 mijë faqe, 100 faqe apo në çfarë mënyrë?.

Eksperti : *unë dokumentacionin e kam marrë këtu në institucion, në mënyrë elektronike dhe një pjesë të dokumenta në mënyrë të shkruar. Por formalisht nuk kam marrë procesverbal sepse është çështje mirëbesimi.*

Përfaqësuesi i Avokatit të Popullit – Dakort. *Besoj që ju janë dhënë dhe si provë këtë statement të bankave, psh. në raportin e ILDKPI-së në faqen 96 faqe është statement i BKT-së, që janë 66 faqe, edhe tek faqe 201 që përsëri janë statement etj, etj.*

Pyetja ka të bëjë me, në pikën 10 të raportit tuaj, tek shpenzimet që e preku edhe kolegja pak më parë, i jeni referuar të dhënave të INSTATIT ndërkohë mund të lind një pyetje, a keni bërë ju një ballafaqim të shpenzimeve teorike mbi bazën e të dhënave të INSTATIT me shpenzimet e të ardhurave reale që juve ju rezulton nga statement të bankave të ndryshme,.....(nuk e dëgjohen disa fjalë këtu)?. Nuk e di, a e kuptuat pyetjen?.

Eksperti- *Tek pjesa e bankës jam marrë me kreditin e bankës, statement të bankës për të nxjerrë të ardhurat e fituara. Dhe normalisht informacioni për pagesat ndërmjet bankës nuk mund të jetë në mënyrë të mirëfilltë dhe vetëm për pjesën e shpenzimeve. Sepse ato mund të jenë tërheqje dhe vetëm blerje. Mund të jenë tërheqje dhe të rritet përsëri prapë. Nuk është se janë argumentuar, veprimi kontabël mungon se për çfarë është tërhequr ai shpenzim!. Mund të jetë me kartë krediti, kesh dhe nuk ka. Nuk është saktësuar natyra e shpenzimit. Unë nuk mund të jap një opinion për të saktësuar dhe të klasifikoj shpenzimet sipas pagesës së bankave.*

Avokati i popullit- *a përputhen këta apo, sa është diferenca?*

Eksperti- *Normalisht kam referuar bankat dhe kjo vlen sipas raportit por po them nuk i klasifikoj dot pagesat e bankës sipas natyrës se shpenzimit të kryer, për shkak se banka nuk e ka të referuar që kjo pagesë e sotme është marrë por po themi për blerjet për një pajisje apo*

për shpenzime pushimi. Prandaj i jam referuar INSTATIT. Po të shikojmë midis mejë dhe ILDKPI-së, ndryshimi është diku tek 800 mijë lekë të reja. Pra, jemi pothuajse aty. Në fund ky është një opinion nuk mund të bëjmë një, pra, këtu nuk është një rezultat financiar. Rezultati financiar del mbi veprimet kontabël dhe mbi dokumentat kontabël. Në japim një opinion financiar mbi situatën dhe dokumentat e paraqitura. Nëse do të kishim një opinion të saktë mbi rezultatin financiar ku të ketë përshkruar në mënyrë të detajuar çdo lloj veprimi të kryer nga banka apo nga subjekti deklarues. Për shkak se subjekti nuk ka qenë subjekt i nënshtruar nga ligji për deklarimin e pasurisë në vitet, normalisht opinionet do të jetë aq sa në kemi marrë informacion nga dosja” .

80. Nga analiza e akteve, të dhënave dhe gjetjeve në procedurën e verifikimit, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi konstaton se me të drejtë ILKPKDI në raportin e saj ka arritur në përfundimet se deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin, dhe se ka mungesë dokumentacioni si dhe ka mosdeklarime të pasurive dhe vlerave të tyre.

81. Kështu, në lidhje me apartamentin që deklaroi kandidatja të ndodhur në Rrugën “Ismail Qemali” Tiranë me sipërfaqe 130 m², rezultoi se kandidatja e ka blerë këtë apartament së bashku me të birin e mitur në atë kohë, shtetasi E.Ç dhe të shoqin shtetasin B.Ç me kontratën 468/372, datë 17.03.2000 nga shtetasi i huaj A.S, kundrejt vlerës prej 3.900.000 lekë dhe me burim dhurim të hollash nga prindrit e kandidates me kontratën nr.3840/445, datë 10.10.1999.

82. Mirëpo rezultoi se edhe nga shpjegimet e kandidates dhënë Këshillit, si dhe leja e legalizimit nr. 118163, datë 02.11.2016, si dhe konstatimet e ILDKPKI –së, se kandidatja së bashku me apartamentin në fjalë, ka blerë efektivisht në vitin 2000 edhe një shtesë kati mbi apartamentin e blerë të përbërë nga 53.6 m² apartament dhe 64.9 m² verandë. Kjo shtesë kati në kohën e blerjes ka qenë pa leje të organit kompetent dhe është ndërtuar nga shitësi.

83. Por nga ana tjetër rezultoi se ky ndërtim pa leje është përfituar me anë të lejes së legalizimit që tregohet më lart dhe se përfituesit e lejes së legalizimit janë kandidatja dhe shtetasi B.Ç dhe E.Ç.

84. Ky dokumentacion provon faktin se efektivisht edhe kandidatja ka blerë përveç 130 m² sipas kontratës që tregohet më lart kundrejt çmimit 3.900.000 lekë, edhe një sipërfaqe 130 m² e cila nuk rezultoi të ketë një çmim në kontratë (shtesa e katit). Është e vërtetë që ky send në atë kohë , pra në kohën e lidhjes së kontratës, nuk kishte hyrë në qarkullimin civil por kandidatja e ka përfituar atë më pas në sajë të lejes së legalizimit dhe për rrjedhojë duhet të provonte çmimin e blerjes së tij dhe mandej edhe ta lidhte këtë çmim me burimin e ligjshëm.

85. Kështu, përveç qëndrimit të ekspertit , sipas të cilit në rast se sipërfaqes prej 130 m² afërsisht të deklaruar në kontratën e shitjes së datës 17.03.2000 do të llogaritej edhe shtesa e legalizuar më pas, **vlera e kontratës do të ishte më e lartë**, pra jo 3.900.000 lekë, Këshilli ka parasysh edhe VKM nr . 214 datë 28.04.1999 “ Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave të Entit Kombëtar të Banesave , të vlerave mesatare të tregut të lirë të banesave dhe të koeficientit K”, ku në pikën 5 shprehet se : “Ngarkohet INSTAT , që, brenda datës 31.5.1999, të sigurojë të dhënat për vlerat mesatare të tregut të lirë të banesave për rrethet Tiranë, Mirditë, Sarandë, Tropojë, Delvinë, Malesi e Madhe” dhe se për vitin 1999 nuk kemi të dhëna të tregut për çmimet e shitjes se banesave në qytetin e Tiranës.

86. Gjithashtu, edhe VKM nr 362 datë 14.07.2000 “ Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave të Entit Kombëtar të Banesave , të vlerave mesatare të tregut të lirë të banesave dhe të koeficientit K”, në tabelën që përmban parashikon se kostoja mesatare për sipërfaqje ndërtimi (lek/m²) në qytetin e Tiranës është 24.780 lekë/m² , pjesa e çmimit per sipërfaqje te ndertimit eshte 5.082 lekë /m² shuma totale është 29.862 lekë /m² . Kostoja mesatare për sipërfaqje shfrytëzimi (lekë/m²) në qytetin e Tiranës është 28.177 lekë/m² , pjesa e çmimit për sipërfaqje të ndërtimit është 5.779 lekë /m² shuma totale është 33.953 lekë /m². Pra edhe me këto **referenca nënligjore** , vlera e kontratës është më e lartë se ajo e deklaruar

87. Sa më sipër, nënkupton **se nuk ka deklarim të saktë të vlerës së apartamentit në fjalë nga kandidatja ashtu si edhe konkludon ILDPKI.**

88. Po kështu, rezulton se kandidatja, me kontratën nr. 5780/2171, datë 30.10.2009, ka lidhur një kontratë për ndërtim apartamenti në Tiranë, në Rezidencën “Kodra e Diellit”, Rruga e Jaseminëve C3, me ndërtues personin juridik “Agi Kons”SHPK kundrejt çmimit 96.750 euro dhe me sipërfaqe 110 m² me burim të ardhurash : Kontratë qeraje nr. 9298/387 të viteve 2009, 2010, kontratë kredie bankare të datës 10.05.2010 në Raiffeisen Bank Sha në shumën 19.122.55 euro dhe kursimet personale të saj dhe bashkëjetuesit (bashkëshortit) shtetasit A.V ndër vite.

89. Apartamenti në fjalë me anë të kontratës së kalimit të të drejtave të pronësisë nr. 1607/798, datë 23.04.2015 i ka kalur shtetasit B.B me pëlqimin e ndërtuesit dhe kandidates. Në këmbim kandidatja me pëlqimin e palëve që tregohen më lart , ka përfituar një apartament me sipërfaqe banimi 156.2 m² në objektin “ Banesë 3 kate plus nënçati në Selitë Tiranë. Sqarohet se apartamenti që ka kandidatja ka këmbyer, ka qenë në kohën e kontratës së datës 30.10.2009 në kuotën +3.06 m². Në kontratë pranohet që palët i kanë shlyer personit juridik të gjithë çmimin që rrjedh nga kontratat përkatëse (përpara kalimit të të drejtave) dhe se ato kanë marrë përsipër të gjitha të drejtat dhe detyrimet që rridhnin nga kontratat e mëparshme.

90. Apartamenti i ri , është regjistruar në regjistrat publikë me numër 109/239/5-11, zona kadastrale 3292, vol. 56, fq 32 dhe i është shitur kandidates nga “Agi Kons” SHPK kundrejt vlerës 117.150 euro sipas kontratës 121/61, datë 23.02.2017.

91. Në vijim , me kontratën me kusht kreditimi nr. 2560/1555, datë 06.06.2018, apartamenti në fjalë është shitur nga kandidatja me pëlqimin e shtetasit A.V blerëses B.D kundrejt çmimit 170.000 euro, që do të paguheshin sipas kontratës 15 000 euro kapar (të likujduara në datë 16.05.2018 sipas kontratës respektive) dhe diferenca nëpërmjet kredisë së dhënë blerësit nga Societe General Albania (Bankë e nivelit të dytë).

92. Në lidhje me sa më lart, rezulton se kandidatja ka kryer rivlerësimin e kësaj pasurie sipas ligjit 81/2016 “ Për rivlerësimin e pasurisë së paluajtshme” dhe nëpërmjet këtij veprimi ajo shpjegon diferencën në çmimin e blerjes dhe atë të shitjes. Por edhe ky fakt vërteton atë se çmimi i shitjes në datë 23.02.2017 nuk ka qenë 117.150 euro dhe se kandidatja ka paguar efektivisht një shumë më të madhe se ajo e nënshkruar në kontratë, përderisa është rivlerësuar për efekt të pagimit të tatimit. Këshilli mban parasysh faktin se kontrata e shitjes së datës 23.02.2017 është lidhur pas hyrjes në fuqi të ligjit 81/2016 dhe se efektet e këtij të fundit shtriheshin sipas nenit 5 të tij deri në datë 28.02.2017. Po kështu, Këshilli mban parasysh se rivlerësimi ka për qëllim që shteti, i përfaqësuar nëpërmjet organit tatimor të arkëtojë tatimin e papaguar mbi kalimin e pasurisë . Kështu neni 1/9 i Ligjit 81/2016 parashikon se : “9. Për

rastet e kalimit të së drejtës së pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme, në zbatim të ligjit “Për tatimin mbi të ardhurat”, të bërë pas rivlerësimit, tatimi llogaritet sipas normave në fuqi mbi fitimin e realizuar, si diferencë e vlerës, në momentin e kalimit të së drejtës së pronësisë, me vlerën e rivlerësuar, për të cilën është paguar tatimi”. Pra, në kuptim të këtij ligji rivlerësimi i kryer nga kandidatja vërteton se ajo ka paguar detyrimet tatimore duke iu referuar vlerës reale së kontratës sipas vlerës së tregut në shumën 170.000 euro por në vetvete rivlerësimi provon faktin që vlera 117.150 euro nuk ka qenë vlera reale.

93. Sa më sipër nënkupton se kandidatja sërish ka mosdeklarim të saktë të vlerës së apartamentit në fjalë.

94. Po kështu, rezulton se në vitin 2013, kandidatja ka blerë një automjet Volkswagen Passat kundrejt shumës 500.000 lekë dhe e ka shitur atë në vitin 2017 në vlerën 13.000 euro. Ky fakt pranohet edhe nga kandidatja me shpjegimin se automjeti është blerë si okazion pasi pala shitëse kishte probleme të rënda financiare dhe se çmimi 13.000 euro i përgjigjet gjendjes së tij teknike fakt që vërtetohet me rishitjen e tij më pas në vitin 2019 në shumën 12.000 euro.

95. Në lidhje me këtë konstatim ose gjetje Këshilli çmon se më të drejtë ILDKPKI ka konstatuar një diferencë të shpërpjesëtuara mes çmimit të blerjes dhe atij të shitjes nga kandidatja. Kjo e fundit duhet të provonte se edhe pse çmimi i shitjes ka qenë okazion si edhe shprehet, ky rast nuk është bërë shkak për shmangien e detyrimeve tatimore.

96. Në lidhje me thelbin e qëndrimit të Avokatit të Popullit, të treguar në pikën 55 të këtij Vendimi, Këshilli çmon të parashtrijë se në lidhje me thirrjen dhe dëgjimin e ekspertit, e që ka gjetur pasqyrim edhe në vendimin gjyqësor të Gjykatës Administrative të Apelit (vendimi nr. 2012, datë 22.08.2019) ku mosthirrja e tij është konsideruar shkelje procedurale nga Gjykata, pikërisht këtë konstatim të Gjykatës, Këshilli e ka zbatuar duke thirrur ekspertin, duke i bërë pyetje sqaruese dhe duke njoftuar edhe kandidaten dhe duke i dhënë mundësinë të paraqesë pyetje ashtu si edhe ka vepruar.

97. Për sa i takon qëndrimit të Avokatit të Popullit se disa çështje kanë nevojë për hetime të mëtejshme për të arritur në një konkluzion pozitiv të ndryshëm nga ai ILDPKI, Këshilli ka parasysh se në lidhje me gjetjet që tregohen më lart dhe që pasjellin ndalimin e kandidates nuk është vendi për kryerjen e veprimeve të tjera verifikuese. Këtu Këshilli ka parasysh se ka marrë edhe provën me ekspert kontabël për të vërtetuar burimin e ligjshëm të pasurive të kandidates. Por Këshilli e quan të nevojshme të theksojë edhe njëherë se ndalimi i kandidates nuk vjen për shkak të të dhënave financiare dhe më këtë kemi parasysh burimin financiar të veprimeve juridike, të konstatuara ndryshe nga ILDKPKI dhe ndryshe nga eksperti. Përkundrazi i gjithë arsyetimi i Këshillit lidhet jo me burimin e të ardhurave në rastet që janë arsyetuar më lart, por në vetvete me faktet juridike që ato përfaqësojnë dhe në rradhë të parë në deklarimin e pasaktë të vlerës së blerjes së tyre.

98. Në lidhje me kërkesën e kandidates, e shprehur në pikën 52 të këtij vendimi, Këshilli çmon se nuk ka asnjë parashikim ligjor që Këshilli të kërkojë nga ILDPKI rihetim të thelluar të kriterit pasuror, në kuadër të verifikimit për kandidimin në Gjykatë Kushtetuese.

99. Neni 235 i ligjit 115/2016 parashikon se :

“1. Menjëherë pas dërgimit të listave me emrat e kandidatëve ose të paraqitjes së shprehjes së interesit nga kandidatët, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi i pajis kandidatët me formularët për deklarin e pasurive dhe të interesave financiarë.

2. Jo më vonë se 15 ditë nga marrja e formularëve për deklarin e pasurive dhe të interesave financiarë, kandidatët i dorëzojnë ato të plotësuara pranë Inspektoratit të Lartë për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, i cili kryen kontrollin e saktësisë dhe të vërtetësisë së deklarinimit brenda 30 ditëve nga paraqitja e tij.

3. Inspektorati i Lartë për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive dhe Konfliktit të Interesave i dërgon menjëherë Këshillit rezultatet e kontrollit.

4. Me përfundimin e procedurës së deklarinimit dhe kontrollit të pasurisë, Këshilli shpall në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, si dhe u komunikon individualisht kandidatëve rezultatit e verifikimit, duke urdhëruar lejimin ose ndalimin e kandidimit. Urdhri për ndalimin e kandidimit është gjithnjë i arsyetuar”.

100. Të gjitha hapat procedural që tregohen më lart janë ndjekur dhe gjejnë pasqyrim edhe në këtë vendim. Kandidates i është komunikuar raporti i ILDPKI-së, ajo ka dorëzuar shpjegimet e saj në lidhje me gjetjet si dhe dokumente provuese. Në këtë kuptim, të gjitha çështjet e ngritura nga ILDKPI dhe të prapësuara nga kandidatja janë hetuar nga Këshilli duke administruar edhe shpjegimet e kandidates si dhe dokumentet e saj dhe për më tepër Këshilli ka marrë edhe provën me ekspert kontabël, pra hetimi i thelluar është ezauruar nga vet Këshilli.

101. Këshilli ka parasysh se si institucion kushtetues, është ai që ka kompetencën ekskluzive të lejimit apo ndalimit të kandidatit përkatës që konkurren në Gjykatën Kushtetuese. Këtë kompetencë ekskluzive ai e realizon jo vetëm mbi të dhënat apo raportet e organeve të tjera publike, si ndodh në rastin konkret me ILDPKI por edhe duke kryer verifikime të pavarura dhe të detajuara të cilat mund ose jo të shpien në përfundime të ndryshme nga raportet e ILDPKI-së. Në këtë kuptim është Këshilli ai që kryen verifikimin përfundimtar verifikimin e pasurisë si kriter kualifikues për kandidatin (gjithmonë jo kandidatin që i nënshtrohet procesit të rivlerësimit kalimtar sipas ligjit 84/20126), ILDPKI e përfundon misionin e saj ligjor me dorëzimin e raportit dhe çdo pretendim i kandidatit qoftë edhe për hetim të thelluar apo edhe vet realizimi i hetimit të thelluar pas dorëzimit të raportit trajtohet nga Këshilli, si edhe ka ndodhur në këtë rast.

102. Pa qenë e nevojshme që të trajtohen dhe konkludohet mbi gjetjet e tjera të ILDKPKI dhe prapësimet e shpjegimet përkatëse të argumentuara hollësisht të kandidates Zhaklina Peto lidhur me to, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi vlerëson se arsyetimi që parashtrohet në pikat 61-87 më sipër, mbi gjetjet në procedurën e verifikimit të pasurisë dhe ligjin e zbatueshëm lidhur me to, është i mjaftueshëm për të ardhur në përfundimin se kandidatja Zhaklina Peto gjendet në kushtet e ndalimit të kandidimit për mospërbushje të kushtit ligjor të parashkuar nga shkronja “dh” e nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000 dhe neni 235 i Ligjit nr. 115/2016.

103 Këshilli vlerëson se kushtet e kandidimit për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të parashkuara nga Kushtetuta dhe ligjet e nxjerra në pajtim me të, duhet të plotësohen secila dhe të gjitha së bashku në mënyrë që kandidati të pranohet për t’u vlerësuar dhe renditur sipas meritave nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi dhe më tej për t’u përzgjedhur gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese nga organi i emërtesës. Në rast se kandidati nuk plotëson qoftë edhe njërin prej kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, kjo do të përbente motiv ligjor të mjaftueshëm për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi për të disponuar ndalimin e kandidimit, pa qenë më e nevojshme të arsyetojë për plotësimin ose jo të kushteve të tjera ligjore.

104. Për këto arsye, duke ardhur në përfundimin se në lidhje me kandidates Zhaklina Peto është i mjaftueshëm të vendoset ndalimi i kandidimit për motivin e mosplotësimit të kushtit ligjor të përcaktuar nga shkronja “dh” e nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000 dhe neni 235 i ligjit nr. 115/2016, Këshilli vlerëson se nuk është vendi për të vijuar me tej me analizë dhe arsyetim mbi plotësimin ose jo të kushteve dhe kritereve të tjera ligjore të kandidimit.

105. Nisur nga sa analizohet dhe arsyetohet më sipër, bazuar në gjetjet dhe të dhënat e konstatuara gjatë procedurës së verifikimit që rezultojnë nga aktet dhe dokumentacionin që përmban dosja e kandidimit, në interpretim dhe zbatim të ligjit të zbatueshëm për kushtet dhe kriteret e kandidimit për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi vjen në përfundimin se duhet të vendoset ndalimi i kandidimit të kandidates Zhaklina Peto, në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e parakohshme, të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 07.02.2018.

PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të pikës 1 të nenit 149/d të Kushtetutës, të nenit 7/a dhe 7/b të ligjit nr. 8577/2000 “ *Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë*” të pikës 3 të nenit 229 dhe pikës 4 të nenit 235 të Ligjit nr. 115/2016 “*Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë*”, si edhe të shkronjës “b” të pikës 50 dhe shkronjës “a” të pikës 77 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi

VENDOSI:

1. Ndalimin e kandidimit të kandidates Zhaklina Peto, në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e parakohshme, të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 07.02.2018.
2. Në zbatim të nenit 238 të Ligjit nr. 115/2016, ky vendim i njoftohet kandidates Zhaklina Peto.
3. Kandidatja Zhaklina Peto ka të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Apelit, jo më vonë se 5 ditë nga dita e njoftimit të vendimit të arsyetuar.
4. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e përcaktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

KRYETARI

Ardian DVORANI

